

Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë

Master i Shkencave

në

Administrim Biznesi

MASTER I SHKENCAVE në ADMINISTRIM BIZNESI

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Cikli i studimeve:	2 vite (i dytë)
Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Administrim Biznesi
Kohëzgjatja e Programit të Studimit:	2 vite (4 semestra)
ECTS:	180 ECTS
Forma e studimit:	Me kohë të plotë
Diploma:	Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”
Gjuha e zhvillimit të programit:	Shqip

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Qëllimi i programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim – Biznesi është të ofrojë studime të thelluara për të gjithë studentët në fushën e administrim-biznesit, të mundësojë zhvillimin e punës kërkimore në këtë fushë si dhe të përgatisë profesionistë në fushën e menaxhimit; zhvillimi në karriere profesionale në një kompani, por edhe përfshirja e *alumni* në veprimtari akademike, krahas punësimit dhe/ose në kërkim shkencor, apo ndjekja prej tij/saj e një programi të ciklit të tretë.

Objektivi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim – Biznesi është që të përgatisë studentët me aftësi të forta e të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve njerëzore, sipërmarrjes, marketingut, menaxhimin strategjik dhe menaxhimin e operacioneve të kërkuara nga drejtuesit dhe/ose aksionarët në menaxhimin profesional të bizneseve. Gjithashtu, ky program studimi synon të përmbushë edhe objektivat në vijim:

- T’ju ofrojë studentëve njohuri bashkëkohore dhe t’ju mundësojë atyre aftësimin në fushën e kontabilitetit dhe atë të financave të nevojshme për menaxhimin e shëndoshë të biznesit dhe për t’u mundësuar atyre të përfitojnë në mënyrë të vazhdueshme nga mjedisi në të cilin operojnë bizneset.
- Të përgatisë studentët me aftësi të drejtimit dhe komunikimit të nevojshme për sipërmarrësit e mirë për të udhëhequr dhe të mbështetur operacionet e reja të biznesit, dhe për të fituar pjesë të tregut nëpërmjet komunikimit efektiv me

konsumatorët, klientët dhe kolegët. Kjo krijohet mbi bazën e fortë të praktikave etike dhe pikëpamjeve të ndryshme.

- T'u zhvillojë studentëve aftësi për të zgjidhur probleme që kanë lidhje me kërkimin, zhvillimin apo inovacionin për të mbështetur operacionet e reja të biznesit, si edhe për të fituar pjesë të tregut.
- Të pajisë studentët me aftësi në menaxhimin e informacionit dhe teknologjitë e komunikimit, si një pjesë përbërëse e programit.

TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

VITI I	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Sjellje Organizative dhe Lidërsip	6	Menaxhim Strategjik	6
	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar	6	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	6
	Menaxhim Projektsh	6	Metoda Kërkimi për Biznesin I	10
	Qeverisja e Korporatave	6	Lëndë me zgjedhje	6
	Total ECTS Semestri I	24	Total ECTS Semestri II	28
	Total ECTS			60

VITI II	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Taksimi i Biznesit	6	Metoda Kërkimi për Biznesin II	8
	Drejtim Financiar i Avancuar	6	Vlerësim Projektsh	6
	Ekonomiks Menaxherial	6	Lëndë me zgjedhje	6
	E Drejta e Biznesit të Avancuar	6	Praktikë Profesionale dhe Raporti i Përvojës Profesionale *	6
			Temë Diplome**	18
	Total ECTS Semestri I	24	Total ECTS Semestri II	36
	Total ECTS			60

*Praktika profesionale zhvillohet paralelisht me zhvillimin e lëndëve në auditor, gjatë gjithë periudhës dy vjeçare të studimit.

**Përgatitja e temës së diplomës fillon që në semestrin e parë të vitit të parë të studimeve, që me fillimin e lëndës: "Metoda Kërkimi për Biznesin 1", dhe vijon përgjate vitit të parë e të dytë, deri në dorëzimin e mbrojtjen e saj në mbyllje të vitit të dytë.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Një diplomë Master i Shkencave në Administrim Biznesi mbulon një gamë të gjerë profilesh, duke përfshirë menaxhimin, financën, marketingun, burimet njerëzore, operacionet dhe strategjinë. Kjo gamë njohurish ofron aftësi të gjithëanshme, që mund të aplikohen në industri dhe sektorë të ndryshëm si: retail, banka, real estate, marketing, teknologji, etj.

Me programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi ju mund të punësoheni në:

- Administratë Publike, qendrore dhe vendore, si specialistë dhe drejtues financiarë, të burimeve njerëzore marrëdhënies me publikun, prokurimeve, menaxhimit të projekteve, etj.
- Sektorin privat, si: specialistë dhe drejtues të financës, kontabilitetit, auditit, burimeve njerëzore, marketingut, shitjeve, marrëdhënies me klientin, menaxhimit të cilësisë, etj.
- Organizata jofitimprurëse, si: specialistë, drejtues dhe vlerësues projektsh, etj.

Me programin Master i Shkencave në Administrim Biznesi ju mund të aftësoheni profesionalisht duke punuar si:

- Sales Manager
- Project Manager
- Operations Manager
- Human Resources Manager
- Project Manager
- Supply Chain Manager
- Account Manager, etj.

TBU ofron mundësi praktike dhe punësimi gjatë kohës së studimeve

Në TBU studentit i ofrohet mundësia e punësimit që gjatë viteve të studimit. Këto mundësi punësimi dhe praktike mundësohen nga mbështetja që BALFIN Group ofron për TBU si pjesë e tij, e gjithashtu nga kompanitë partnere që TBU bashkëpunon.

TBU bashkëpunon me mbi 150 kompani, zyra ligjore apo institucione financiare ku studentët mund të kryejnë praktika apo të punësohen, si:

- Tirana Bank
- BALFIN IT
- Jumbo
- Neptun
- Balfin Real Estate
- Balfin Construction

- Fashion Group Albania
- ACREM
- Spar Albania
- Raiffeisen Bank
- NOA Financo, etj

REZERVIMET E HERSHME

Për programet Master studentët kanë mundësi përfitimi të reduktimit të tarifave nëpërmjet rezervimeve të hershme.

Tirana Business University ofron reduktim të tarifës së studimit për ata studentë që rezervojnë vendin e tyre në një kohë sa më të hershme.

KONTAKTONI

Rruga Rezervat e Shtetit, pranë TEG, Tiranë, Shqipëri

Cel: +355697066966

web: www.tbu.edu.al

e-mail: admissions@tbu.edu.al